

janar, 2026

Të nderuara familje,

Si vetë emigrant, e di sa thelbësore janë komunitetet tona shkollore për nxënësit dhe familjet e emigrantëve - dhe sa shumë kontribuojnë nxënësit dhe familjet tona emigrante në shkollat tona.

Në shkollatpublike të qytetit të Nju-Jorkut (NYCPS), ne ofrojmë një arsim të fortë, gjithëpërfshirës dhe mbështetës për çdo nxënës dhe familje, pavarësisht statusit të tyre të emigracionit.

Si rikujtesë, NYCPS-ja **nuk** u ofron agjencive ligjzbatuese jo-vendore qasje te nxënësit, ambientet shkollore ose të dhënat, përveç nëse kërkohet me ligj, dhe vetëm pas konsultimit me avokatët e NYCPS.

Në qytetin e Nju-Jorkut, shkollat tona janë vende të sigurta për fëmijët tanë. Nëse ndonjë nxënës ose familje ka pyetje ose shqetësime në lidhje me një incident imigracioni, ne i inkurajojmë ata të kontaktojnë drejtorin e shkollës së tyre për t'u lidhur me mbështetjen e duhur.

Gjithashtu, ne kemi shumë burime në dispozicion të stafit dhe familjeve tona përmes iniciativës sonë Project Open Arms, e cila ofron mbështetje për nxënësit emigrantë dhe familjet e tyre. Për më shumë informacion, vizitoni schools.nyc.gov/ProjectOpenArms.

Për më tepër, NYCPS-ja vazhdon të bashkëpunojë me Zyrën e Kryetarit të Bashkisë për Qështjet e Imigrantëve (MOIA). Ne i inkurajojmë familjet të përdorin linjën telefonike të ndihmës ligjore të MOIA-s në numrin 1-800-354-0365 ose të vizitojnë nyc.gov/immigrants për të mësuar më shumë.

Si kancelari juaj, jam i përkushtuar për t'u siguruar që shkollat tona të mbeten hapësira të sigurta dhe gjithëpërfshirëse për nxënësit dhe familjet.

Në bashkëpunim,



Kamar H. Samuels, kancelar